



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE

Nr. 735 Akti

Korce ne date 09.07.2020

“NJOFTIM ME SHPALLJE PUBLIKE”

(Per njoftimin e séances gjyqesore)

Drejtuar per afishim: Ne kendin e njoftimeve prane Njesise Administrative Libonik

Per shtetasen e paditur: Dorina Grabolli, datelindja 05.06.1994.

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe eshte duke u gjykuar çeshtja civile qe i’u perket paleve:

Padites/e: Guljan Hanelli

E paditur: Dorina Grabolli

Objekti: Zgjidhje martese dhe rregullimin e pasojave

Referuar njoftimeve te derguara dhe pohimeve te pales paditese Juve ndodheshit jashte territorit te Republikes se Shqiperise

Gjykata pasi ezauroi etapat procedurale per njoftimin Tuaj sipas neneve 129-133 te K.Pr.Civile, si me siper, vendosi te procedoje me njoftimin nepermjet shpalljes publike, bazuar ne nenet 133/a dhe 133/b, te K.Pr.Civile, duke u afishur nje kopje e shpalljes prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe, si gjykata ku gjykohet mosmarreshja, nje kopje prane Njesise Administrative Miras dhe Njesise Administrative Libonik, nga nje kopje ne deren e baneses se fundit te vendbanimit Tuaj zyrtar Libonik dhe ne banesen e origjines ne fshatin Cete, si dhe ne faqen zyrtare te gjykates, per t’u njoftuar per padine, aktet shoqeruese dhe seancen pajtimore date 01.07.2020, ora 10:00

Seanca pergatitore/pajtimore date 01.07.2020 u zhvillua ne mungesen tuaj dhe ne prani personalisht te pales paditese Guljan Hanelli i cili parashtroi se nuk mund te arrihet pajtimi.

Ne perfundim ne baze te nenit 135 te K.Familjes dhe te nenit 158/c te K.Pr.Civile Gjykata vendosi kalimin e ceshtjes ne séance gjyqesore ku do te administrohen si prova certifikata e martesese, certificate familjare dhe dy certifikata personale.

Séanca u planifikua ne date 07.09.2020, ora 13⁰⁰, por kjo séance nuk mund te zhvillohet per shkak se perkon me dite pushimi zyrtar, dita e shenjetimit te Nene Terezese.

E vene ne dijeni per sa me siper, Gjykata planifikoi seancen pasardhese per ne date 09.09.2020, ora 9³⁰.

Nepermjet ketij njoftimi Ju bejme me dije sa me siper pra seanca gjyqesore eshte planifikuar te zhvillohet ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Korçe date 09.09.2020, ora 9³⁰.

Mosparaqitja tuaj si e paditur, pa shkak, passjell zhvillimin e gjykimit ne mungese.

Kjo shpallje do te qendroje e afishuar ne vendet e afishuar minimalisht 20 (njetzet) dite nga dita e neserme e afishimit.

GJYOTARE
SONJELA VOSKOPI



- Uj. Ad. Libonik
- Drg. Tek. Inf. Publik ✓
13.07.2020
elkep

Mr. SG Prot
Date 14.07.2020